




Shpallur Monument Kulture i Kategorisë së parë (I) në vitin 1948, Kalaja e Bashtovës është gjithashtu në listën tentative të UNESCO-s si Vend i Trashëgimisë Botërore.

Një herë e një kohë, zona ku ndodhet kalaja ishte qendër tregëtimi e përdorur nga Venediksit. Më pas, gjatë Perandorisë Osmane, kalaja u kthye në port me funksion mbrojtjen e tregtisë bregdetare. Për këtë arsye, arkitektura veneciane dhe osmane ndërthurren bukur në strukturën e kalasë.

Në kuadër të restaurimit të Kalasë së Bashtovës, janë kryer këto ndërhyrje arkitekturore:

- Restaurimi dhe plotësimi i qemerëve të tullës.
- Restaurimi i bedenave të dëmtuar.
- Restaurimi i shkallëve të gurit.
- Ndriçim artistik i mureve të kalasë në pjesën e brendshme dhe të jashtme të tyre.
- Pajisja e një pjese të murit me parapet metalik, për të siguruar mbrojtjen e vizitorëve gjatë lëvizjes mbi mur.
- Plotësimi i njerës prej kullave me strukturë dekorative metalike.
- Mbyllja e aksesit në disa pjesë të murit ku ecja mund të jetë e rrezikshme.











